



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË**

Numri i lëndës: 2020:181445
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05628439

K.Dh.Sh.II.nr.1634/22

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Devolli Corporation” ShPK me seli në Pejë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” me seli në Prishtinë kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.57/22 të datës 12.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Devolli Corporation” ShPK me seli në Pejë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.57/22 i datës 12.09.2022, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa ka mbetur në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/839, 865 i datës 29.09.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit ta gabuar të dispozitave materiale me propozimin që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit dhe të anulohet si i pabazuar në tërësi aktgjykimi i kontestuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës. Nr.01.3.2.2/839, 865 të datës 29.09.2020, është aprovuar pjesërisht kërkesa e subjektit në

procedurë “Devolli Corporation” ShPK - Pejë tek pika I e aktvendimit nr.03.1.7-2017-1149/20.10.2017 të Sektorit për Kundërvajtje Doganore, ulet gjoba nga 3,500.00€ si ishte, në 1,700.00€, ndërsa pikat tjetra të këtij aktvendimi mbeten të pandryshuara, tek pika II Ndryshohet aktvendimi i Sektorit për Kundërvajtje Doganore nr.03.1.7-2017-1149/20.11.2017, lidhur me gjobën administrative, tek pika III Refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë “devolli Corporation” ShPK – Pejë, të ushtruar ndaj aktvendimit nr.03.1.1-2017-181 të datës 07.11.2017 të Sektorit për Kontroll Pas Importues.

Gjykata e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/839,865 të datës 29.09.2020, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 12.09.2022, në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/839, 865 të datës 29.09.2020. Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative, gjithmonë në rastet kur nuk kemi Informatë Tarifore Detyruese të BE-së, për mallin kontestues nga paditësi. Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se, nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as në këtë konflikt administrativ Gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë dëshmi për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar përmes DUD-ve kontestues, mbi bazën e të cilit deklarim paditësi është liruar nga pagesa e taksës doganore prej 10%. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se në rastet kur nuk kemi Informatë Tarifore Detyruese të autoriteteve nga shteti eksportues apo i origjinës të deklaruar nga paditësi në procedurë të zhdoganimit të mallit dhe/apo shqyrtimit gjyqësor atëherë e paditura me të drejtë është bazuar në Mendimin për Klasifikim Tarifor nr. 98/06.11.2017, të dhënë nga Sektori i Tarifave për mallra identike apo të ngjashme i cili vepron në kuadër të paditurës. Nuk është kontestues fakti se Informacioni tarifor i detyrueshëm gjen zbatim me nenin 18, par 1 dhe 2, të KDAK-së, dhe do të jetë detyrues për Doganën ndaj personit të cilit i është lëshuar informacioni vetëm lidhur me klasifikimin tarifor të mallit, dhe se Informacioni tarifor i detyrueshëm është detyrues vetëm lidhur me mallrat, për të cilat formalitetet doganore janë përfunduar pas datës në të cilën janë pajisur me informata. Gjykata duke i pasur parasysht dispozitat ligjore të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku shprehimisht parashihen dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore e ku në mes tjerash në paragrafin 1, pika C thuhet; *“Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruar”*, konstaton se ka qenë obligim i paditësit që në procedurë administrative tek e paditura por edhe pranë Gjykatës të ofrojë prova konkrete *“informatë tarifore detyruese”* për të mbështetur kodin tarifor të deklaruar, për vendosje të mallit lëndor në qarkullim të lirë, gjë të cilën nga shkresat e lëndës rezulton që paditësi nuk e ka bërë, e sidomos në rastet kur në kodin tarifor të deklaruar sipas TARIK-ut aplikohet lirime nga detyrimet doganore Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka ofruar provat relevante gjegjësisht informatën detyruese tarifore nga vendi eksportues ose i origjinës së mallit, andaj Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestuese, për arsye se, e paditura Dogana e Kosovës referuar Mendimit për Klasifikim Tarifor nga Sektori i Tarifës nr. 98/06.11.2017, si sektor i specializuar i cili vepron në kuadër të paditurës, me të drejtë ka

konstatuar se në rastin konkret malli lëndor është dashur të tariforet sipas përshkrimit në numrin-kodin tarifor 8443321090, sipas të cilit kod tarifor për mallin e deklaruar duhet të paguhet taksa doganore prej 10% në vlerë prej 1,052.94€ dhe diferenca e TVSH-së në shumë prej 189.52€, apo gjithsej taksa doganore prej 1,242.47€, dhe pasi që kanë konstatuar se këtu paditësi me anë të deklaratës doganore kontestuese R-892/22.01.2016, nuk e ka deklaruar saktë kodin tarifor për mallin lëndor, kjo edhe sipas mendimit të Sektorit të Tarifës nr. 98/06.11.2017, e paditura e ka shpallur përgjegjës këtu paditësin, bazuar në nenin 276, pika k), e KDA-së, duke i shqiptuar gjobë në të holla në shumën prej tani sipas vendimit kontestues 1,700.00 euro. Deri tek përfundim lidhur me klasifikimin e saktë tarifor e paditura ka ardhur duke u bazuar në rregullat e përgjithshme numër 1-6 për interpretimin e TARIK-2017, e në bazë të shënimeve shpjeguese të seksionit XVI, kapitullit 84, fotove të dërguara, shënimeve sqaruese të sistemit të harmonizuar dhe nomenklaturës së kombinuar. Gjykata ka gjetur si jo të bazuar pretendimin e këtu paditësit lidhur me deklaratën eksportuese ku i njëjti mall sipas paditësit është paraqitur me numër tarifor të deklaruar si në këtë deklaratë, kjo për faktin se deklarata eksportuese përpilohet mbi bazën e faturës dhe të dokumenteve përcjellëse të mallit, dhe se e njëjta nuk është dokument për aplikim të preferencave tarifore në shtetin e destinimit, në këtë rast të Kosovës.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Gjykata e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183 i LPK-së, këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se Gjykata e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata e Shkallës së Parë me të drejtë ka gjetur se paditësi ka dështuar të prezantoj provat si Informatën Tarifore Detyruese të autoriteteve nga shteti eksportues, për mallin sipas DUD-it kontestues R-892/22.01.2016, e me të cilën do të mbështeste pretendimet e tij si në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, sepse, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Gjykata e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një

aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1634/22, me datë 26.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova

Numri i lëndës: 2020:181445
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05628439